



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenint 81 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-42, në bazë të nenint 61 par.26, 27, 28 dhe 29 i Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe në bazë të kontratës së lidhur me datë 13.01.2019 ndërmjet Operatorit Ekonomik "RIDVAN ELEZI" B.I. me adresë: Pellazgët 18A, 20000, Prizren, Kosovë dhe Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.10.2020, palët arritën këtë:

**MARRËVESHJE PËR NDËRPRERJEN E KONTRATËS ME TITULL
"NDËRTIMI I STREHIMORES PËR QENTË ENDACAK DHE TRAJTIMI I TYRE"
ME NR. TË PROKURIMIT: 616 19 194 521**

Autoriteti Kontraktues dhe Operatori Ekonomik me datë 13.01.2019, kanë lidhur kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "NDËRTIMI I STREHIMORES PËR QENTË ENDACAK DHE TRAJTIMI I TYRE" ME NR. TË PROKURIMIT: 616 19 194 521, me ç'rast pas konstatimit nga Menaxheri i Kontratës se Operatori Ekonomik pas dërgimit të njoftimit me datë: 03.09.2020 i cili ka theksuar se "*pas vizitës në teren dhe në vendin ku është planifikuar ndërtimi i objektit mungon infrastruktura komplet: përfshirë: rruga shumë e dëmtuar, mungesë e rrjetit të ujësjellësit, mungesë të rrjetit elektrik ku nuk janë të përfshirë në projekt. Gjithashtu përveç kësaj nuk ka pasur leje ndërtimore, ku me datë 02.09.2020 është konfirmuar leja për fillimin e punimeve pra diku nëntë muaj pas nënshkrimit të kontratës dhe si rezultat i përhapjes së pandemisë (COVID 19) kemi mungesë të stafit duke filluar nga menaxheri i projektit dhe disa punëtor që janë larguar nga puna dhe si rezultat i kësaj është e pamundur të fillojnë punimet dhe të përfundon projekti".*

Palët pas konstatimeve të tyre, me ç'rast Operatori Ekonomik "RIDVAN ELEZI" B.I. deklaroi se nuk mund të përfundojë punimet përshkak të pengesave administrative, juridike dhe asaj të shfaqjes së pandemisë (COVID 19), palët u dakorduan që të ndërpritet Kontrata.

Kjo marrëveshje ndërmjet palëve është arritur në mënyrë miqësore në bazë të kushteve të veçanta të kontratës në nenin 42, par.2.

Të iu dërgohet:

Operatorit Ekonomik "RIDVAN ELEZI" B.I.

Komisionit për Menaxhim të Kontratës




Departamentit të Prokurimit

a) Komisioni i Menaxhimit të Kontratës



Hyrishahe Morina (menaxhere e Kontratës)

Afrim Gashi (anëtar)

Seniha Bajraktari (anëtare)


b) Operatori Ekonomik "RIDVAN ELEZI" B.I



Aprovuar nga: Departamenti i Prokurimit

Zekë Bardhaj (Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit)



Prishtinë

02.10.2020.